



Datë: 05.09.2025
Numër Protokolli: 5996/2025

A.nr.1450/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtare, me Sabile Avdyli- në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1450/2025 të datës 22.07.2025, të parashtruar nga ankuesi N.R, kundër organit të punësimit: Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 05.09.2025, me shumicë votash Kolegji mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1450/2025 e datës 22.07.2025, e parashtruar nga ankuesi, N.R.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, N.R (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 22.07.2025 përmes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 4980/2025, nën shenjën A.nr.1450/2025, lidhur me klasifikimin e vendit të tij të punës në klasën Profesional 2.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, ankuesi është i punësuar në Zyrën e Kryeministrit dhe se i njëjti, sipas Akt emërimit me numër protokolli Nr.prot.245/2024 të datës 08.07.2024, mbanë pozitën e punës *Zyrtar i Transportit*, në Divizionin/Njësinë e Transportit.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, pozita të cilën e mbanë do të duhej të klasifikohet nga klasa Profesional 3, me koeficientin e pagës G6/4.3, në klasën Profesional 2, me koeficientin e pagës G5/5.3. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin përkatës të punësimit që pozitën e tij ta klasifikoj sipas klasës Profesional 2.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim

i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Zyra e Kryeministrit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit në këtë rast Zyra e Kryeministrit, nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e parakohshme, dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës së theksuar më lart, ankuesit do t'i lind e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1450/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, N.R;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.